



INFEKSIONET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME!



Kingdom of the Netherlands





Çfarë janë Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme – IST-të?

Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme janë infeksione që transmetohen gjatë kontaktit seksual të pambrojtur, me dikë që është i infektuar. Por disa infeksione seksualisht të transmetueshme mund të përhapen edhe në mënyra të tjera siç janë: kontakti lëkurë me lëkurë, puthja etj.

Infeksionet Seksualisht të Trasmteshme shkaktohen nga viruse, bakterie dhe parazitë. Ato prekin si femrat ashtu edhe meshkujt.

Infeksionet Seksualisht të Trasmteshme janë nga më të ndryshmet, nga ato që japin vetëm një bezdi të lehtë deri tek ato me pasoja nga më seriozet, nëse ato nuk trajtohen në kohë. Për fat të mirë, shumica e infeksioneve seksualisht të transmetueshme kanë shërim të plotë, por ka edhe nga ato që nuk shërohen si HIV - AIDS-i.

Sot numërohen më tepër se 25 lloje infeksionesh seksualisht të transmetueshme, ndër të cilat: Gonorreja, Sifilizi, Hepatiti B Dhe C, Klamidia, HPV, Herpesi, Trichomoniasis, Morrat Pubike, HIV- AIDS

Punoi: **Geri Koçllari**
Student I Fakultetit të Mjekësisë Tiranë.

Tiranë, Shqipëri 2019.



Ky punim u mundësua nga organizata Open Mind Spectrum Albania (OMSA), dhe u mbështet financiarisht në kuadër të projektit Youth Activist for Change (YAC) nga Ministria e Jashtme e Hollandës.

Open Mind Spectrum Albania (OMSA) në bashkëpunim me Ambasadën e Vendeve të Ulëta në Tiranë, Ministrinë e Punëve të Jashtme në Hollandë, organizatën partnere Hollandeze Stichting Art.1, dhe organizatat partnere në Shqipëri, Në Dobi të Gruas Shqiptare, Open Doors, Përtej Barrierave dhe Akademia e Filmit & Multimedias MARUBI, po zhvillojnë Projektin Youth Activist for Change, një projekt i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës, i cili do të zhvillohet në vitet 2018-2020 në vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Serbi dhe Maqedoni).

Çfarë është hepati viral?



Hepatiti viral është inflamacion i mëlçisë, i njohur si verdhëza, i shkaktuar nga viruse të ndryshme. Ka disa lloje hepatitesh virale A, B, C, D dhe E, në varësi të llojit të virusit që i shkakton. Hepatiti viral prek qindra miliona njerëz në mbarë botën duke shkaktuar sëmundje akute dhe kronike të mëlçisë, si dhe është një nga shkaqet kryesore të vdekjes në nivel global. Në veçanti, llojet B dhe C të hepatitit çojnë në sëmundje kronike qindra miliona njerëz, dhe së bashku janë shkaku më i zakonshëm i cirrozës dhe kancerit të mëlçisë që shpesh përfundojnë në vdekje.

Çfarë është hepatiti viral B?

Hepatiti B është një infeksion i mëlçisë, potencialisht kërcënues për jetën, që shkaktohet nga virusi i hepatitit B dhe që mund të shkaktojë sëmundje akute dhe kronike. Ai mund të shkaktojë sëmundje kronike të mëlçisë, dhe i vë njerëzit në rrezik të lartë vdekjeje nga cirroza dhe kanceri i mëlçisë. Kanceri i mëlçisë është pothuaj gjithmonë fatal, dhe shpesh zhvillohet te persona që janë në moshën më produktive dhe që kanë përgjegjësi familjare.

Si transmetohet hepatiti viral B?

Virusi i hepatitit B transmetohet nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me gjakun, me spermën apo lëngun vaginal të një personi të infektuar. Mënyrat e transmetimit janë të njëjta si për virusin HIV, por virusi i hepatitit B është 50 deri në 100 herë më infektues. Ndryshe nga virusi HIV, virusi i hepatitit B mund të mbijetojë jashtë trupit së paku për 7 ditë. Gjatë kësaj kohe, virusi mund të shkaktojë infeksion nëse hyn në trupin e një personi i cili nuk është i mbrojtur nga vaksina.

Çdo njeri që bie në kontakt me gjakun apo lëngje të tjera të trupit të një personi të infektuar me virusin e hepatitit B, është i rrezikuar të infektohet. Rreziku është më i madh nëse personi:

- Shpohet me age të infektuara.
- Injekton drogë me të njëjtën shiringë që ka përdorur një person i infektuar me hepatit B.
- Përdor mjetet personale si furçën e dhëmbëve apo mjetet e rojes të personit të infektuar.
- Bën seks me një person të infektuar pa përdorur prezervativ.
- Ka më shumë se një partner seksual apo i ndërron shpesh ata.
- Bën tatuazhe apo vendos vathë (piercing) me mjete të ndotura që i ka përdorur më parë një person i infektuar.



- Nëna shtatzënë e infektuar me virusin e hepatitit B mund të infektojë fëmijën e saj të porsalindur.

Hepatiti B nuk përhapet nëpërmjet kontaktit të përditshëm si: puthja, përqaqimi, kollitja, teshtitja, kapja apo shtërngimi i duarve, ose përdorimi i përbashkët i enëve të kuzhinës. Virusi i hepatitit B nuk përhapet nga ushqimi apo uji i kontaminuar, dhe nuk mund të përhapet rastësisht në vendin e punës.

Cilat janë shenjat hepatitit viral B?

Periodha e inkubacionit të hepatitit B është mesatarisht 75 ditë, por mund të variojë nga 1 deri 6 muaj. Shumica e njerëzve nuk përjetojnë asnjë shenjë gjatë fazës të fshehur të infeksionit. Kur shfaqen shenjat ato përfshijnë: zverdhje të lëkurës dhe syve, urinë të errët, lodhje ekstreme, të përzjera, të vjella dhe dhimbje barku. Virusi i hepatitit B mund të shkaktojë infeksion kronik të mëlçisë, që më vonë mund të kalojë në cirrozë apo kancer të mëlçisë. Gjasat që infeksioni me virusin e hepatitit B të bëhet kronik, varet nga moshën në të cilën një person infektohet. Fëmijët e vegjël të cilët infektohen me virusin e hepatitit B kanë më shumë gjasa për të zhvilluar infeksione kronike

Si diagnostikohet?

Nëse një person është i infektuar, kjo mund të konstatohet vetëm nëpërmjet bërjes së testit të gjakut. Një numër testesh janë në dispozicion për të diagnostikuar personat me hepatit B. Por, për fat të keq, një pjesë e njerëzve nuk e dinë që janë të infektuar sepse nuk kanë shenja të dukshme. Kur ata fillojnë të kenë shenja, dëmtimet kanë përparuar.

Si trajtohet?

Nuk ka trajtim specifik për hepatitin akut B, ndërsa hepatiti B kronik mund të trajtohet me barna, përfshirë interferonin. Trajtimi mund të kushtojë mijëra dollarë në vit, prandaj nuk është në dispozicion për shumicën e njerëzve në vendet në zhvillim.

Kush është në rrezik për infeksion kronik të mëlçisë?

Gjasat që infeksioni me virusin e hepatitit B të bëhet kronik, varet nga moshën në të cilën një person infektohet. Fëmijët më pak se 6 vjeç të cilët infektohen me virusin e hepatitit B kanë më shumë gjasa për të zhvilluar infeksione kronike:

80-90% e foshnjave të infektuara gjatë vitit të parë të jetës, dhe 30-50% e fëmijëve të infektuar para moshës 6 vjeç zhvillojnë infeksion kronik. Rreth 15-25% e të rriturve me infeksion kronik, të cilët janë infektuar gjatë fëmijërisë, vdesin nga kanceri apo cirroza e mëlçisë të lidhura me hepatitin B.



Si parandalohet?

Vaksina kundër hepatitit B është në dispozicion që nga viti 1982, duke parandaluar infeksionin dhe pasojat kronike të tij. OBSH-ja rekomandon që të gjithë fëmijët të marrin vaksinën e hepatitit B sa më shpejt të jetë e mundur pas lindjes, brenda 24 orëve. Doza e lindjes duhet të pasohet nga 2-3 doza të tjera për të përfunduar gjithë skemën e vaksinimit. Përveç vaksinës e cila ka një siguri dhe efektivitet të lartë, zbatimi i strategjive të tjera të sigurisë së gjakut, duke përfshirë sigurimin e testimit të të gjithë gjakut të dhuruar dhe komponentëve të tij të përdorur për transfuzion, mund të parandalojë transmetimin e virusit të hepatitit B. Praktikrat e injeksioneve të sigurta, duke eliminuar injeksionet e panevojshme dhe të pasigurta, mund të jenë strategji efektive për t'u mbrojtur kundër transmetimit të virusit të hepatitit B. Gjithashtu, praktikrat më të sigurta seksuale, përfshirë minimizimin e numrit të partnerëve dhe përdorimin e masave mbrojtëse/prezervativë mbrojnë kundër transmetimit të virusit të hepatitit B.



Çfarë është hepatiti viral C?

Hepatiti është një sëmundje infektive që shkaktohet nga virusi i Hepatitit C që prek në mënyrë primare mëlçinë. Virusit mund të shkaktojë hepatit akut dhe kronik, me intesitet që varion nga forma e lehtë deri në formë të rëndë, kërcënues për jetën.

Si transmetohet?

Virusi i hepatitit C transmetohet nëpërmjet gjakut dhe produkteve të tij. Mënyrat më të shpeshta të transmetimit janë:

- Injektimi i drogës me të njëjtën shiringë që ka përdorur një person i infektuar me hepatit C
- Ripërdorimi ose mosterilizimi i duhur i pajisjeve mjekësore.
- Transfuzioni i gjakut dhe i produkteve të gjakut të infektuar me Virusin e Hepatitit C
- praktika seksuale që cojnë në ekspozim me gjak (si pshb, ndërmjet meshkujsh, vecanërisht në ata të infektuar me Hiv ose në ata që marrin profilaksi përpara ekspozuesve kundrejt infeksionit me Hiv.
- Gjithashtu mund të transmetohet nëpërmjet kontaktit seksual ose mund të transmetohet nga nëna tek fëmija.
- Hepatiti C nuk shpërndahet nëpërmjet ushqimit me gji, ujit të pijshëm ose kontakteve të rastësishëm si përqafimet, puthjet apo ndarja e ushqimeve me personin e infektuar.

Cilat janë shenjat e hepatitit viral C?

Periodha e inkubacionit (e fshehtësisë, dukjes pa shenja klinike) për hepatitin C shkon nga 2 javë deri në 6 muaj. Pas infektimit fillestar, përafërsisht 80 për qind e njerëzve nuk shfaqin asnjë simptomë. Ata njerëz që shfaqin shenja mund të kenë ethe, lodhje, rënie të oreksit, të përziera, të vjella, dhimbje barku, urinë të errët, feçe të çngjyrosura në gri, dhimbje të kyçeve, si dhe zverdhje të lëkurës dhe të bardhës së syve.

Si diagnostikohet?

Për shkak të faktit se infeksioni akut me virusin e hepatitit C është zakonisht simptomatik, çka do të thotë pa simptoma paralajmëruese, diagnoza e hershme e infeksionit është e rrallë. Tek ata njerëz që zhvillojnë infeksionin kronik, infeksioni mund të mbetet i padiagnostikuar deri kur shfaqen dëmtime serioze të mëlçisë. Infeksioni me virusin e hepatitit C diagnostikohet nëpërmjet një

testi serologjik. Nëse personi diagnostikohet me infeksion kronik të hepatitit C, duhet të bëjë një vlerësim të shkallës së dëmtimit të mëlçisë nëpërmjet biopsisë së mëlçisë, ose testeve të tjera të rekomanduara nga një mjek specialist. Diagnoza e hershme mund të parandalojë problemet shëndetësore që mund të rezultojnë nga infeksioni, si dhe të parandalojë transmetimin e virusit te të tjerët.



Si trajtohet?

Hepatiti C, jo gjithmonë kërkon trajtim, mbasi te disa njerëz një përgjigje e fortë imunitare pastron infeksionin, ndërkohë që tek disa të tjerë me infeksion kronik, nuk zhvillon dëmtime të mëlçisë. Por, nëse trajtimi është i nevojshëm duhet përzgjedhur me kujdes, me qëllim përcaktimin e metodës më të përshtatshme për pacientin sipas skemave bashkekohore.

Si parandalohet?

Akoma nuk ka vaksinë për hepatitin C. Megjithatë, rreziku i infeksionit mund të reduktohet duke shmangur rrezikun e ekspozimit ndaj infektimit si: injeksionet e panevojshme dhe të pasigurta, produktet e pasigurta të gjakut, grumbullimin e pasigurt të shiringave e mbetjeve, përdorimin e drogave të paligjshme dhe shkëmbimin e mjeteve të injektimit, seksin e pambrojtur me njerëz të infektuar me hepatit C, ndarjen e sendeve personale të mprehta që mund të jenë ndotur me gjak të infektuar, bërjen e tatuazheve, piercings dhe akupunkturën me pajisje të infektuara dhe të pasterilizuara, etj.



Çfarë është HIV?

HIV është virusi i cili prek dhe dobëson sistemin imunitar të organizmit të njeriut duke e lënë atë të pambrojtur nga infeksionet dhe nga disa lloje kanceri.

Çfarë është AIDS?

Faza më e avancuar e infeksionit HIV është AIDS, i cili mund të zgjasë nga 2 deri në 15 vjet për t'u zhvilluar, në varësi të individit. AIDS është përcaktuar si zhvillimi i llojeve të ndryshme të kancerit, infeksioneve apo manifestimeve të tjera të rënda klinike. HIV nuk është sinonim i AIDS. Një person i infektuar me virusin HIV, jo domosdoshmërisht është i sëmurë me AIDS; ai mund të jetë i infektuar me virusin HIV por mund të mos jetë i sëmurë me AIDS.

Si transmetohet HIV-i?

Transmetimi i HIV-it mund të ndodhë nëpërmjet shkëmbimit të një shumëllojshmërie lëngjesh të infektuara të trupit të njeriut si gjaku, qumështi i gjirit, sperma dhe sekrecionet vaginale.

Disa nga sjelljet dhe kushtet që vënë individët në rrezik më të madh për t'u infektuar me HIV përfshijnë:

- Marrëdhëniet seksuale vaginale ose anale të pambrojtura.
- Pasja e një infeksioni tjetër seksualisht të transmetueshëm si sifilizi, herpesi, klamidia, gonorea dhe vaginosa bakterore.
- Shkëmbimi i mjeteve të kontaminuara si gjilpëra, shiringa e pajisje të tjera gjatë injektimit të drogës.
- Marrja e injeksioneve apo transfuzioneve të gjakut të pasigurta, transplantit i organeve, si dhe procedurat mjekësore me instrumente të mprehta të kontaminuara.
- Shpimet aksidentale me gjilpërë (përfshirë dëmtimet e stafit shëndetësor).

Individët nuk mund të infektohen me HIV nëpërmjet kontaktit të zakonshëm të përditshëm si puthjet, përqaqimet, takimi i duarve, ose ndarja e objekteve personale, ushqimit apo ujit, etj.

Cilat janë shenjat e AIDS?



Shenjat ndryshojnë në varësi të fazës së infeksionit. Shumë prej njerëzve që jetojnë me HIV nuk janë në dijeni të gjendjes së tyre HIV pozitiv deri në fazat e mëvonshme. Javët e para pas infeksionit fillestar, këta persona mund të mos kenë asnjë shenjë ose mund të shfaqin shenja të ngjashme me gripin si: ethe, dhimbje koke, skuqje apo dhimbje të fytit. Me dobësimin progresiv të sistemit imunitar, infeksioni përparon dhe një person mund të zhvillojë edhe shenja të tjera të cilat ndryshojnë në varësi të fazës së infeksionit si: fryrje e nyjeve limfatike, humbje e madhe në peshë, ethe/temperaturë, diarre e vazhdueshme, kollë. Pa trajtim mund të shfaqen edhe shenja të tjera sipas llojit të infeksioneve të ndryshme oportuniste.

Si diagnostikohet HIV dhe AIDS?

Sot janë në dispozicion teste të ndryshme që zbulojnë praninë ose mungesën e antittrupave të HIV-it. Ritestimi i individëve që diagnostikohen me HIV është praktikë e mirë për të përjashtuar çdo gabim të mundshëm testimi apo raportimi. Të gjitha shërbimet e testimit të HIV-it duhet të ndjekin parimet e rekomanduara nga OBSH-ja: miratim i informuar, konfidencialitet, këshillim, rezultate të sakta të testimit dhe lidhje me kujdesin, trajtimin dhe shërbimet e tjera.

Si mjekohet?

Me barnat e reja antivirale parandalohet shumëfishimi i virusit duke shmanhur shfaqjen e ndërlikimeve jetëkërcënuese, duke rritur kështu, jetëgjatësinë e pacientëve.

Parandalimi i HIV-it?

Individët mund të zvogëlojnë rrezikun e infektimit me HIV duke kufizuar ekspozimin ndaj faktorëve të rrezikut.



Shënjat e stadit të avancuar

Shënjat e stadit fillestar



1. Temperaturë



2. Dhimbje gryke



3. Gjendra lymfatike të enjtura



4. Ekzantema – puçra në trup



5. Lodhje



6. Dhimbje kyçesh



7. Dhimbje në muskuj



1. Lodhje insistente




2. Djersitje natën




3. Humbje e peshës



4. Diarre insistente



5. Shikim i turbullt




6. Njolla të bardha në gjuhë edhe në gojë



7. Kollë e thatë



8. Veshtirësi në frymëmarje



9. Temperaturë që mbahet për shumë javë



10. Gjendra lymfatike të enjtura

Çfarë është PrEP?

PrEP-i (Profilaksia përpara ekspozimit nënkupton marrjen e barnave antiretrovirale nga personat HIV-negativë, përpara ekspozimit të mundshëm ndaj HIV-it. PrEP (Truvada) ndalon shumëfishimin e virusit në trup. Kur merret përditë, PrEP është 99% i efektshëm për parandalimin e infektimit me HIV. Mqs PrEP mbron vetëm ndaj HIV-it, prezervativët janë të rëndësishëm për mbrojtjen nga SST e tjera.



Çfarë është PEP?

PEP (Profilaksia pas ekspozimit) nënkupton marrjen e barnave antiretrovirale nga personat HIV-negative, pas ekspozimit të mundshëm ndaj HIV-it, në mënyrë që të parandalohet infektimi. PEP-i përdoret vetëm në situata emergjente dhe duhet përdorur brenda 72 orëve pas ekspozimit të mundshëm ndaj HIV-it. Sa më shpejt të fillohet terapia, aq më të mëdhaja janë mundësitë për t'u parandaluar infektimi. PEP-i duhet marrë 1 ose 2 herë në ditë, për 28 ditë rrjesht. PEP-i është i efektshëm kur administrohet në mënyrë të duhur, por jo 100%.



1. Çfarë është papilloma virus njerëzore?

Virusi i papilomës njerëzore (Papiloma virus ose HPV) është përgjegjësi i kancerit në qafën e mitrës, i pari tumor i njohur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si tumor totalisht me prejardhje nga një infeksion.

Ekzistojnë 1200 lloje të ndryshme nga këndvështrimi gjenetik (gjenotipe) të virusit HPV, i aftë të infektojë njeriun, një e treta është i lidhur me sëmundjet (patologjike) të pjesës anogenitale, qoftë beninjë ashtu edhe malinjë. Nga këta gjenotipe, tipi 16 është përgjegjës i gati 50% të rasteve të kancerit në qafën e mitrës, tipi 18, përgjegjës i 20 % dhe pjesa mbetëse 30%. Gjenotipet 6 dhe 11 janë përgjegjës të lythave gjenitale.

2. Si ndeshet ky infeksion?

Infeksioni nga HPV është më i përhapuri në infeksionet nëpërmjet trasmetimit seksual. Kështu, për të trasmetuar këtë infeksion është e mjaftueshme një kontakt i thjeshtë në zonën gjenitale (edhe raport seksual jo i plotë). Prania e mbartësve të shëndoshë është shumë e përhapur në shoqëri. Në përgjithësi qoftë burri ashtu edhe gruaja nuk paraqesin shënja të dukshme të infeksionit, edhe pse janë në gradë ta trasmetojnë atë. Profilaktikët (prezervativët), duhet të përdoren gjithmonë për parandalimin e sëmundjeve seksualisht të trasmetueshme, por nuk garantojnë mbrojtje të plotë kundrejt virusit HPV.

3. Cilat janë shqetësimet që shkakton infektimi nga HPV?

Infektimi nga virusi HPV, nuk paraqet asnjë shqetësim të vecantë. Pjesa më e madhe e infeksioneve shërohet në mënyrë spontane pa pasoja. Vetëm një minorancë e infeksioneve bëhet kronike, dhe është pikerisht në këto situata që virusi, në zhvillim edhe brenda pak viteve, mund të çojë në plagët ose çarjet para – kanceroze. Në fakt nëse këto shenja nuk njihen (nëpërmjet Pap-testit) dhe nuk kurohen në mënyrën e duhur mund të kthehen në kancer të qafës së mitrës.

4. Si përballohet infektimi nga Papiloma virus?

Për infeksionin nuk ekziston një kurë e posaçme. Për parandalimin dhe diagnostikimin në mënyrë të menjëhershme ndryshimin e qelizave të qafës së mitrës që mund të jenë të provokuara nga ky virus, kërkohet të kryhet në mënyrë të rregullt Pap-test (testi i Papanikolaut, për nder të ideatorit). Flitet për një analizë, në gjendje të verifikojë ndryshimin e qelizave në qafën e mitrës. Në këtë

mënyrë është e mundur të kuptohet në kohë që po formohen ndryshime të dyshimta në materialet e qafës së mitrës. Është e dukshme pra që vaksina, nuk kuron, por parandalon infeksionin.



5. Ka shërim nga ky infeksion?

Kur është marrë infeksioni nga një ose disa tipe të papiloma virus, është imuniteti i trupit që çon në shërim, në pjesën më të madhe të rasteve. Tipet 16 dhe 18 janë shpesh përgjegjes të infeksioneve kronike dhe të kalimit pas 10 vjetëve në kancer të qafës së mitrës.

6. Mund të merret për herë të dytë?

Po, teorikisht është e mundur të merret për herë të dytë infeksioni me të njëjtin tip të HPV, sepse mbrojtjet e brendshme të trupit, imuniteti, është i fortë, por zgjat pak: çarja është e lokalizuar dhe virusi nuk emigron në gjak. Vetëm vaksina dominon nivelin mbrojtës të paktën 10 herë më shumë, konsiston për më shumë se 8 vjet.

7. Çfarë rëndësie ka HPV në gjenerimin e tumorit të qafës së mitrës?

Infeksioni i përhershëm nga virusi HPV onkogjen (i aftë domethënë të gjenerojë tumore) është pra një kusht i domosdoshëm për të zhvilluar tumorin në qafën e mitrës.

8. Vaksinimi kundër HPV 16 dhe 18 ndalojnë infeksionin?

Vaksinimi është demonstruar i aftë të pengojë krijimin e infeksioneve akute nga HPV, shkaktuar nga tipet virale që përmban vaksina, pengon kalimin në infeksion kronik dhe zhvillimin e tij deri në çarjet para-kancerogjene (të domosdoshme për të arritur në tumorin e vërtetë).

9. Parashikohet vaksinimi edhe tek meshkujt?

Nuk parashikohet për momentin një ofertë gratis e vaksinimit për meshkujt, sepse për ta nuk ka asnjë rrezik siç është për shembull tumori i qafës së mitrës tek femrat.

10. Gratë shtatzana mund të vaksinohen?

Vaksinimi nuk mund tju kryhet grave shtatzana



11. Është efi­kase vak­si­na?

Nga studimet klinike mbi sigurinë e vak­si­nës, rezul­ton që vak­si­na nëse kryhet kur femra nuk ka akoma kontakte me virusin, siguron një mbrojtje të lartë (90 -100%) për­sa i për­ket çar­jeve para-kanceroze të pro­vo­kuara nga HPV të tipit 16 dhe 18.


12. Vak­si­na zë­vendëson kon­tro­llin pe­ri­odik (screening Pap-test)?

Është e do­mos­do­shme të kuj­tojmë që vak­si­na punon kra­h për kra­h, por nuk zë­vendëson Pap-testin për tu­morin e qafës së mitrës, ak­tu­alisht i re­komandue­shëm për gratë e moshës nga 25 deri në 64 vjeç, dhe që kryhet çdo 3 vjet.

13. Çfarë është HPV test? Eshtë e do­mos­do­shme të kryhet së bashku me Pap- testin?

Testi HPV bazohet në iden­ti­fi­ki­min e tipeve HPV, që ndoshta kane infektuar or­ga­net ge­ni­ta­le të gru­as. Ek­ze­ku­timi i këtij testi është i do­mos­do­shëm për të sta­bi­li­zuar mënyrat dhe kohën për ndërhyrjen mjekësore. Në të ardhmen, testi HPV do të zë­vendësoje Pap-testin tek gratë në moshë të madhe

Shën­jat (Simptomat)



1. Një ose në shumë nivele të mprehta të mëdha ose të vogla ose në formën e lulë­l­akrës xhunga në or­ga­net ge­ni­ta­le dhe reth anusit (kondyloma)



2. Lezione në qafën e mitres

Çfarë është Gonorrea?

Gonorrea është një sëmundje seksualisht e transmetueshme, që shkaktohet nga bakteri *Neisseria gonorrhoeae*. Infeksioni mund të prekë organet gjenitale, gojën, dhe rektumin.



Cilat janë shenjat e saj?

Femrat:

Dhimbje e theksuar gjatë urinimit.

Sekretion jo i zakonshëm nga vagina, i cili mund të jetë i dendur dhe të ketë ngjyrë jeshile ose të verdhë.

Dhimbje, shqetësim ose sekretion nga anusi.

Dhimbje në pjesën e poshtme të barkut.

Hemorragji jashtë menstruacioneve, menstruacionet janë më të rënda.

Dhimbje, enjtje, iritacion dhe rrjedhje të syve.

Meshkujt:

Dhimbje dhe djegie gjatë urinimit.

Sekretion ko të zakonshëm nga ana e penisit i cili mund të jetë me ngjyrë të bardhë, të verdhë ose jeshile.

Dhimbje, shqetësim ose rrjedhje nga anusi.

Enjtje e lëkurës që mbulon penisin.

Dhimbje, ndjeshmëri e shtuar në testikuj ose prostatë.

dhimbje, enjtje, iritacion i syve.

Të porsalindurit:

Skuqje e syve, enjtje e syve me rrjedhje të dendur me qelb brënda dy javëve.

Si transmetohet?

Gonorrea transmetohet nga një person te tjetri nëpërmjet seksit vaginal, oral dhe anal. Transmetohet dhe nga nena tek i porsalinduri duke shkaktur infeksion të syve. Mund të transmetohet dhe nëpërmjet objekteve që janë të kontaminuara me lengje të ndryshme të trupit.

Si diagnostikohet?

Prania e infeksionit vërtetohet me anë të testeve laboratorike specifike, të cilat janë mjaft të ndjeshme në identifikimin e tij.

Si trajtohet?



Gonorrea mjekohet me përdorimin e antibiotikëve specifike si: azithromycine, ceftriaxone. Është e rëndësishme që mjekimi të fillojë sa më shpejt, në mënyrë që të shmangen ndërlikimet e shumta që ajo jep. Shërimi i sëmundjes nuk shkakton imunitet, pra ekziston rreziku që të riinfektohemi me të përsëri.

Cilat janë masat mbrojtëse?

Kryerja e marrëdhënieve seksuale monogamike (marrëdhënie seksuale vetëm me një person) i cili është i kontrolluar dhe nuk është i infektuar.

Përdorim sistematik dhe i saktë i prezervativit në çdo lloj kontakti seksual, gjatë gjithë zgjatjes së marrëdhënies, por vendosja e tij pakëson por nuk përjashton mundësinë e infektimit.

Kontrulli periodik i të dy partnerëve për të kapur sëmundjen sa më përpara.


Shënjat - Gratë



1. Dhimbje e theksuar gjatë urinimit



2. Sekretion jo i zakonshëm nga vagina, i cili mund të jetë i dendur dhe të ketë ngjyrë jeshile ose ngjyrë të verdhë



3. Dhimbje, shqetësim ose sekretion -rrjedhje nga anusi



4. Dhimbje e ndjeshme në pjesën e poshtme të barkut (jo e zakonshme)



5. Hemoragji në intervalin midis menstruacioneve, menstruacionet janë më të rënda (jo të zakonshme)



6. dhimbje, enjtje, iritacion dhe rjedhje nga sytë



Shënjat - Burrat




1. Dhimbje dhe ndjenjë djegjeje gjatë urinimit




2. rrjedhje (sekrecion) jo i zakonshëm nga ana e penisit i cili mund të jetë me ngjyrë të bardhë, të verdhë ose jeshile




3. Dhimbje, shqetësim ose sekrecion-rrjedhje nga anusi



4. Inflamacion (enjtje) e lëkurës që mbulon anën e penisit



5. Dhimbje, ndjeshmëri në testikujt ose tek prostata (rrallë)



6. dhimbje, enjtje, iritacion dhe rjedhje nga sytë



Çfarë është Klamidia?

Klamidia është një sëmundje seksualisht e transmetueshme, e cila shkaktohet nga bakteri *Chlamydia trachomatis*. Prek të dyja gjinitë. Mund të shkaktojë dëmtime serioze, të përhershme, sidomos në aparatit riprodhues femëror.

Cilat janë shenjat e saj?

Dhimbje gjate urinimit

Rrjedhje jo e zakonshme nga penisi, vagina dhe anusi.

Dhimbje në testikujt nga burrat.

Hemorragji midis menstruacioneve ose pas kryerjes së kontaktit seksual tek femrat.

Menstruacione me gjakderdhje jo normale.

Dhimbje, shqetësim, rrjedhje ose hemorragji nga anusi.

Dhimbje, enjtje, iritimi dhe sekrecion nga sytë.

Si transmetohet?

Klamidia transmetohet nëpërmjet seksit vaginal, anal, oral ose nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me indet e infektuara si konjunktiva. Transmetohet gjithashtu nga nëna tek foshnja gjatë aktit të lindjes.

Si diagnostikohet?

Pasi pacienti dyshon se mund të jetë infektuar, paraqitet tek mjeku duke kryer analizat përkatëse si: Testet e amplifikimit të acidit nukleik siç janë Polymerase Chain Reaction (PCR), Transcription mediated amplification (TMA) dhe DNA strand displacement amplification (SDA).

Si trajtohet?

Klamidia trajtohet plotësisht me antibiotikë të tillë si: azithromycin, doxycycline, erythromycin, levofloxacin ose ofloxacin. Pacienti duhet të riezaminohet përsëri pas 3 muajsh për të përjashtuar rrezikun e riinfeksionit. Nuk përftohet imunitet pas kalimit të suksesshëm të infeksionit.

Cilat janë masat mbrojtëse?

Kryerja e marrëdhënieve seksuale monogamike (marrëdhënie seksuale vetëm

me një person) i cili është i kontrolluar dhe nuk është i infektuar.
Përdorim sistematik dhe i saktë i prezervativit në cdo lloj kontakti seksual, gjatë gjithë zgjatjes së marrëdhënies, por vendosja e tij pakëson por nuk përjashton mundësinë e infektimit.
Kontrolli periodik i të dy partnerëve për të kapur sëmundjen sa më përpara.







Shënjat (Simptomat)



1. Dhimbje gjatë urinimit



2. Sekretion (rrjedhje) jo e zakonshme nga penisi, vagina dhe nga anusi



3. Dhimbje në testikujt tek burrat



4. Hemoragji në intervalin midis menstruacioneve ose pas kryerjes së kontaktit seksual tek gratë.




5. Dhimbje në pjesën e poshtme të barkut



6. Menstruacione më të rënda tek gratë



7. Dhimbje, shqetësim, sekrecion (rrjedhje) ose hemoragji nga anusi



8. Dhëmbje, enjtje, irrimim dhe sekrecion (rrjedhje) nga sytë

Çfarë është Herpes Simplex?



Herpes simplex Virus, ose i njohur si HSV, është një infeksion që shkakton herpes. Herpesi shfaqet në pjesë të ndryshme të trupit, më së shumti në organet gjenitale ose në gojë. Ka dy tipe virusesh: HSV-1 shkakton herpesin oral dhe është përgjegjës për fluskat e vogla në lëkura dhe në membranat mukoze, si dhe plagë të ftohta mbi buzë dhe/ ose përgjatë anëve të hundës, të cilat njihen edhe si fluska ethesh. Prek gjithashtu dhe sistemin nervor qendror. HSV-2 shkakton herpesin genital.

Cilat janë shenjat?

Shpeshherë pacientët janë asimptomatikë por mund të shfaqin dhe shenja të tilla si:

një ose më shumë fluska mbi ose rreth organeve gjenitale, anusit ose gojës të cilat cahen dhe krijojnë plagë të dhimbshme.

temperaturë

dhimbje në trup

gjëndra limfatikë të enjtura

ndjesi kruajtjeje, djegieje, shpimi gjilpërash ne zonat e fluskave.

Si transmetohet infeksioni?

Virusi ngjitet zakonisht përmes kontaktit seksual (vaginal, oral, anal). Virusit mund të ngjitet nga kontakti me lëkurën e infektuar ose sekrecionet e dikujt që është prekur nga virusi, edhe nëse nuk ekzistojnë plagë të dukshme në lëkurë. Gjithashtu nëse personi që vuan nga HSV, prek këto plagë ose lëngjet e këtyre plagëve, mund ta transferojë këtë në pjesë të tjera të trupit të tij. Kjo përben problem të vecantë, vecanërisht në pjesë të tilla delikate si sytë.

Si diagnostikohet?

Herpesi oral diagnostikohet nëpërmjet ekzaminimit nga ana e mjekut. Fluskat janë tipike, te cilat ndihmojnë në identifikimin e infeksionit.

Herpesi genital është më i vështirë për tu diagnostikuar për shkak të ngjashmërisë me infeksione të tjera. Mund të përdoren teste laboratorike të ndryshme si: kultura e virusit, fluoreshenca direkte e antitropave, biopsia e lezionit, ose polymerase chain reaction (PCR), por kostoja e lartë e këtyre testeve nuk e justifikon përdorimin në praktikë.



Si trajtohet?

Asnjë metodë nuk e zhdruk virusin nga trupi, por mjekimi me anti-virale ul shpeshtësinë, kohëzgjatjen dhe ashpërsinë gjatë fazës së sëmundjes. Analgjezikë të tillë si ibuprofen dhe paracetamol ndihmojnë në uljen e temperaturës dhe së ndjesisë së dhimbjes. Anestetike lokalë si prilocaine, lidocaine, benzocaine mund të zbusin të kruarat dhe dhimbjen.


Cilat janë masat mbrojtëse?

Kryerja e marrëdhënieve seksuale monogamike (marrëdhënie seksuale vetëm me një person) i cili është i kontrolluar dhe nuk është i infektuar.


Përdorim sistematik dhe i saktë i prezervativit në cdo lloj kontakti seksual, gjatë gjithë zgjatjes së marrëdhënies, por vendosja e tij pakëson por nuk përjashton mundësinë e infektimit.

Kontrolli periodik i të dy partnerëve për të kapur sëmundjen sa më përpara.


Shënjat (Simptomat)




1. Një ose më shumë fluska mbi ose reth organeve genitale , anusit ose gojës të cilat çahen dhe krijojnë plagë të dhimbshme.



2. Temperaturë



3. Dhimbje në trup



4. Gjendra limfatike të enjtura

Çfarë është Sifilizi?

Sifilizi shkaktohet nga bakteri i quajtur *Treponema pallidum*. Është sëmundje komplekse që shkakton simptoma të shumëllojshme, në varësi të stadi të sëmundjes.



Cilat janë shenjat?

një ose më shumë (zakonisht të padhimbshme) plagë të vogla të rrumbullakta në regjionin e organeve gjenitale ose në regjionin e anusit, në gojë osë edhe kudo tjetër.

ekzantëme (puçrra) në pëllëmbët dhe në shputat ose në pjesë të tjera të trupit.

lodhje

temperaturë

dhimbje koke

gjëndra limfatike të enjtura

humbje e qimeve në pjesë të ndryshme të trupit

rënie e peshës

dhimbje kyçesh

Si transmetohet infeksioni?

Sifilizi ngjitet nëpërmjet:

Kontaktit të ngushtë me plagë të infektuar d.m.th. kur goja juaj, organet tuaja gjenitale ose ndonjë pjesë tjetër e trupit tuaj prek plagët e një personi tjetër që janë shkaktuar nga sifilizi. Zakonisht ngjitet nëpërmjet kontaktit seksual (vaginal, oral, anal) me dikë që ka sifiliz.

Përmes përdorimit të përbashkët të sendeve të mprehta si brisqe, age, shiringa

Nga një nënë tek foshnja gjatë periudhes së shtatzanisë.

Si diagnostikohet?

Është i vështirë për t'u diagnostikuar gjatë periudhës së hershme së infeksionit. Konfirmohet nëpërmjet analizave të gjakut ose inspeksionit direkt nga ana e mjekut. Analizat e gjakut janë më të thjeshta e më të mira për vendosjen e diagnozës.

Si trajtohet?

Është e rëndësishme që sëmundja të diagnostikohet në faza sa më të hershme. Në varësi të stadi të sëmundjes, përcaktohet dhe mjekimi me antibiotikë të



ndryshëm si: benzylpenicilline, doxycycline, tetracycline, ceftriaxone etjr. Me regjimin e duhur teraupetik, semundja kalohet plotësisht.


Cilat janë masat mbrojtëse?

Kryerja e marrëdhënieve seksuale monogamike (marrëdhënie seksuale vetëm me një person) i cili është i kontrolluar dhe nuk është i infektuar.

Përdorim sistematik dhe i saktë i prezervativit në cdo lloj kontakti seksual, gjatë gjithë zgjatjes së marrëdhënies, por vendosja e tij pakëson por nuk përjashton mundësinë e infektimit.

Kontrulli periodik i të dy partnerëve për të kapur sëmundjen sa më përpara.


Shënjat (Simptomat)



1. Një ose më shumë (zakonisht të padhimbshme) plagë të vogla të rrumbullakta në regionin e organeve gjenerale ose në regionin e anusit, në gojë ose edhe kudo tjetër.




2. Ekzantemë (puçrra) në pëllëmbët dhe në shputat ose në pjesë të jera të trupit.



3. lodhje




4. Temperaturë (rrallë)



5. Dhimbje koke




6. Gjendra limfatike të enjtura p.sh. në qafë, në sqetulla



7. Humbje e qimeve këtu dhe atje (rrallë)



8. Rënie e peshës



9. Dhimbje kyçesh (rrallë)



Çfarë është Trichomoniasis?

Trichomoniasis është një sëmundje infektive e shkaktuar nga paraziti *Trichomonas vaginalis*.

Cilat janë shenjat?

Rreth 70% e meshkujve dhe femra nuk kanë simptoma kur infektohen. Simptomat fillojnë zakonisht 5 deri në 25 ditë pas ekspozimit. Ato përfshijnë:

- Rrjedhje vaginale të bardha me nuance gri ose të verdhë.
- Rrjedhje nga penisi tek meshkujt.
- Erë të rëndë e të fortë vaginale.
- Irritim dhe djegie vaginale.
- Djegie dhe irrimim brënda penisit.
- Dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale.
- Dhimbje gjatë urinimit.

Si transmetohet infeksioni?

Transmetohet nëpërmjet seksit oral, vaginal apo anal me personin e infektuar. Kalohet gjithashtu nga nëna tek fëmija, gjatë aktit të lindjes.

Si diagnostikohet?

Diagnoza vendoset me teste të ndryshëm si: marrja e sekrecioneve vaginale apo penile dhe gjetja e parazitit nëpërmjet pamjes me mikroskop, kultura parazitare apo dhe testet e reja laboratorike si testet me antigjene apo te amplifikimit të ADN-se.

Si trajtohet?

Trajtimi me Metronidazole është mjekimi i zgjedhur.

Cilat janë masat mbrojtëse?

Kryerja e marrëdhënieve seksuale monogamike (marrëdhënie seksuale vetëm me një person) i cili është i kontrolluar dhe nuk është i infektuar.

Përdorim sistematik dhe i saktë i prezervativit në çdo lloj kontakti seksual, gjatë gjithë zgjatjes së marrëdhënies, por vendosja e tij pakëson por nuk përjashton mundësinë e infektimit.

Kontrulli periodik i të dy partnerëve për të kapur sëmundjen sa më përpara.

Çfarë janë morrat pubike?

Morrat pubike janë një infeksion seksualisht i transmetuëshëm. Shkaktohet nga paraziti i quajtur Phthirus pubis.



Cilat janë shenjat?

Gjate inspektimit të lëkurës mund të vini re vezët ose format e rritura të parazitit të fiksuar pas qimeve, të cilat mund të jene qimet pubike apo rreth anusit, të këmbëve, parakrahut, gjoksit, rrallë te qerpikët, vetullat, sqetulla apo në mjekër. Ato mund të shkaktojnë puçrra të skuqura, të shoqëruara më të kruara në zonën e lëkurës përreth.

Si transmetohen?

Transmetohen nëpërmjet kontaktit seksual ose të ngushtë trupor me një person të infektuar. Infeksioni është më i zakonshëm tek të rinjtë, sidomos tek ata që i ndërrojnë shpesh partnerët seksualë.

Si diagnostikohet?

Mjeku mund ta vërë diagnozën nëpërmjet ekzaminimit objektiv, ndonjëherë duke përdorur dhe një xham zmadhues. Ndonjëherë është e vështirë të shihen me sy të lirë dhe mund të përdoret mikroskopi për të parë morrat.

Si trajtohet?

Morrat pubike trajtohen me solucion që aplikohet në të gjitha zonat me qime të trupit, nga qafa e poshtë. Ky solucion duhet të lihet për një kohë të caktuar, në varësi të tipit të përdorur dhe mund të jetë e nevojshme të përsëritet pas një jave. Rrobat dhe çarçafet duhen të lahen në lavatrice me të paktën 50 gradë celsius për të vrarë morrat dhe vezët.

Cilat janë masat mbrojtëse?

Moskryerja e marrëdhënieve seksuale me partnerët e infektuar. Pastrimi i shtretërve dhe rrobave të personave të infektuar.



Ku mund të bëhen analizat e IST-ve?

Fillimisht duhet konsultuar me mjekun e familjes për këshilla, testim dhe trajtim, dhe ai do tju thotë se çfarë do të bëni.

Mjeku mund t'u kërkojë të bëni një analizë të sekrecioneve genitale, një analizë urine, ndonjëherë dhe një analizë gjaku. Mjeku gjithashtu mund tu pyesi nëse dëshironi të bëni një test për IST-të. Asnjë prej këtyre testeve nuk është i dhimbshëm. Vajtja tek mjeku do t'ju ndihmojë të qetësoheni. Për disa analiza rezultati mund të merret menjëherë për disa të tjera duhen disa ditë ose më tepër. Ndërsa prisni për përgjigjen e analizës ju nuk duhet të kryeni marrëdhënie seksuale. Nëse ju mendoni se ja keni transmetuar infeksionin partnerit duhet t'ja thoni në mënyrë që të bëjë edhe ai/ajo një test. Jini të sigurtë e të ndershëm me të. Në disa shtete konsiderohet kriminale të mos ta bëshë këtë.

Testimet mund të kryhen pranë:

1. Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), Tiranë.
2. Laboratorët mikrobiologjik në Qendrën Spitalore Universitare, “Nënë Tereza” Tiranë, QSUT.
3. Laboratorët mikrobiologjik në Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe.
4. Qendrat e Këshillimit e Testimit Vullnetar pranë DSHP-ve, në 12 qarqet e vendit.
5. Spitalet Private.
6. Duke u interesuar pranë organizatave përkatëse që merren me këto çështje.

Referencat:

1. *Harrison's Infectious Diseases* Dennis L. Kasper Anthony S. Fauci 2018
2. *Infectious Diseases* Mandell, Douglas and Bennett's 2015
3. *Instituti i Shëndetit Publik Shqiperi*
4. *Netter's Infectious Diseases* Elaine C. Jong Dennis L Stevens 2014